



Worcester Child Development

Programi Head Start

Worcester Public Schools

www.worcesterschools.org

Ndërton Një Të Ardhme Për Fëmijët Dhe Familjet E Tyre

Broshurë Familjare

Ju falenderojme që keni zgjedhur Head Start si program parashkollor për fëmijën tuaj. Për më shumë se 45 vjet, Head Start u ka shërbyer me krenari dhe sukses familjeve që jetojnë në Worcester.

Programi jonë i ofron fëmijës tuaj një bazë të fortë për vazhdimin e të mësuarit gjatë jetës, dhe në mënyrë aktive angazhon gjithë familjen.



Ndërtimi i Trurit në Progres

Facebook Worcester Headstart  Twitter @WorcHeadstart  <http://headstart.worcesterschools.org/>

Shkollat Publike Worcester janë një Mundësi e Barabartë/Punëdhënes me Veprim Afirmativ/Institucion Edukimi që nuk bën dallim pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, besimit fetar, origjinës kombëtare, gjendjes civile, prirjeve seksuale, identitetit gjinor, paaftesisë apo vendstrehimit. Shkollat Publike Worcester sigurojnë punësim të barabartë dhe një sërë programesh edukimi të përgjithshëm dhe profesional. Për më tepër informacion në lidhje me këtë Mundësi të Barabartë /Veprim Afirmativ, kontaktoni Manaxherin e Burimeve Njerëzore, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020

Vendndodhja e Ndërtesave
dhe
Numrat e Telefonit

Shkolla Greendale

130 Leeds Street

Worcester, Massachusetts 01606

(508) 799-3227 Zyra Qëndrore (Main Office)

(508) 799-3243 Mbështetësi i Shërbimeve Familjare (Family Service Advocate)

(508) 799-3244 Infermieri (Nurse)

Shkolla Mill Swan / A

337 Mill Street

Worcester, Massachusetts 01602

(508) 799-3498 Zyra Qëndrore

(508) 799-3251 Mbështetësi i Shërbimeve Familjare

(508) 799-3239 Infermieri

Shkolla Mill Swan / B

337 Mill Street

Worcester, Massachusetts 01602

(508) 799-3255 Zyra Qëndrore

(508) 799-3262 Mbështetësi i Shërbimeve Familjare

(508) 799-3256 Infermiera

Shkolla Millbury Street

389 Millbury Street

Worcester, Massachusetts 01610

(508) 799-3235 Zyra Qëndrore

(508) 799-3696 Mbështetësi i Shërbimeve Familjare

(508) 799-3236 Infermiera

Pamja e Përgjithëshme e Programit

Programi Head Start i Worcester për Zhvillimin e Fëmijës bazohet në premisën se të gjithë fëmijët ndajnë disa nevoja. Pozicioni i kësaj filozofie është se një fëmijë mund të përfitojë nga një program i plotë, ndërdisiplinor që nxit zhvillimin e tyre social/emocional dhe promovon aftësitë e përgatitjes për në shkollë. Familjet janë në gjendje që të kenë akses të një game të gjërë shërbimesh që përfshijnë kontrolle shëndetësore, shërbime të edukimit special, programe ushqimi dhe dentare, si dhe shërbimet e angazhimit dhe mbështetjes familjare. Programi ndërtohet në bazë të anëve të forta të çdo anëtari të familjes, dhe të eksperiencave unike të fëmijës. Familja konsiderohet të jetë influenca kryesore e zhvillimit të fëmijës së tyre dhe inkurajohet që të jetë aktivisht e angazhuar në edukimin e fëmijës së tyre në mënyrë që të arrihen rezultate pozitive.

Deklarata e Misionit

Misioni i Programit Head Start të Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës, i Shkollave Publike të Worcester-it, është që të ofrojë një program para-shkollor të cilësisë së lartë, që i përgatit fëmijët për të pasur sukses kur të dalin në jetë. Programi shton vetëbesimin dhe rritjen personale të të gjithë fëmijëve përfshirë ata me nevoja speciale, e gjithë kjo duke përgatitur çdo fëmijë që kur të fillojë shkollën të jetë gati për të mësuar. Ndërtuar në anët e forta të çdo familjeje, qëllimet, dhe roli si mësuesi i parë i fëmijës së tyre, Head Start punon në partneritet me fëmijët, familjet, dhe komunitetin për të promovuar dhe mbëdhetur zhvillimet e shëndetëshme.

Informacioni i Licensimit Departmenti i Edukimit të Hershëm dhe Kujdesit

Programi Head Start i Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës i vendosur në Shkollën Greendale, Shkollën Mill Swan dhe Shkollën Millbury Street janë pjesë e sistemit të Shkollave Publike të Worcester-it dhe si pasojë janë të përjashtuara/liruar nga licensimi. Këto objekte plotësojnë ose tejkalojnë të gjitha kërkesat dhe udhëzimet e licensimit lokale, shtetërore, dhe federale si edhe Standartet e Performancës Head Start dhe Aktin Head Start.

Një kopje e çertifikatës së përjashtimit/lirimit nga licensimi nga Departamenti i Edukimit të Hershëm & Kujdesit ndodhet e vendosur në të gjitha objektet e Head Start.

Programi Head Start i Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës është i akredituar nga Shoqata Kombëtare për Edukimin e Fëmijëve të Vegjël. (National Association for the Education of Young Children) (NAEYC)

Pranimi&Regjistrimi

Në mënyrë që fëmija të regjistrohet në Programin Head Start duhet të jenë në dispozicion dokumentat e mëposhtëm:

1. Verifikim i datëlindjes-Shembull:Certifikata e Lindjes
2. Vërtetim i Banimit-Shembull:Faturë nga kompanitë e shërbimit
3. Vërtetim i të ardhurave (të ardhurat duhen të jenë brenda udhëzimeve të përcaktuar nga Qeveria Federale)
4. Vërtetim i vaksinave të deritanishme dhe i kontrollit fizik aktual

Fëmijët me nevoja speciale merren në konsideratë të veçantë.

Nuk ka tarifë për programin e pjesshëm ditor/Një tarifë progresive mund të aplikohet për opsionet me ditë/kohë të plotë

*Vendosjet për në ditën/kohën e plotë mund të kërkojnë dokumentacin shtesë për të përcaktuar pranimin.

Për më shumë informacion kontaktoni: Specialistin e Hyrjes të Head Start

**Zyra Administrative e Head Start
Taylor Building
770 Main Street
Worcester, MA 01610
(508) 799-3608**

Nga e Hëna-Të Premte, 8:00 a.m. – 4:30 p.m. (Satf dygjuhësor në dispozicion)

Ndodhet ngjitur me Qendrën e Informimit të Prindit të Shkollave Publike të Worcester-it dhe Shkollës Jacob Hiatt

**Kërkesa për rekordet e vaksinimit mund të hiqet përkohësisht për një fëmijë që kualifikohet si i pastrehë sipas Aktit McKinney-Vento për Asistencë për të Pastrehët .*



Ndërtimi i Trurit në Progres

Opsionet e Programit

9:00 AM - 12:30 PM dhe 1:00 PM - 4:30 PM - (Financimi i Head Start)

Familjet që marrin TANF ose Siguri të Ardhurash Suplementare (Families Receiving TANF or Supplemental Security Income)

Fëmijët nën Kujdestari pavarësisht të Ardhurave (Children in Foster Care regardless of Income)

Fëmijët me nevoja speciale ose të pastrehë (Children with special needs or homeless)

8:00AM -3:00 PM dhe 7:30 AM - 4:30 PM - (Financimi i Head Start & EEC)

Prindërit duhet që të jenë në shkollë ose të punojnë minimalisht 20 orë në javë

Udhëzimet Federale për të ardhurat aplikohen për opsionet e mësipërme Federal

Programi me Gjysëm-Kohe (Half Day)

- *Certifikata e Lindjes së Fëmijës*
- *Vërtetim i të Ardhurave të Familjes (DTA, SSI, SSDI, Mbështetja e Fëmijës, Asistencë etj.)*
- *Vërtetim i Adresës (faturë shërbimi /kontratë qiraje)*
- *Identifikim me Fotografji i Prindit*
- *Kartat e Social Security ose pasaporta (prindi & fëmija)*
- *Karta e Siguracionit Shëndetësor & Rekordet e Vaksinimit*

Programi me Kohë të Plotë(Full Day) (Veç dokumentave të mësipërm)

- *Social Security Cards or passport(Parent & Child)*
- *Karta e Siguracionit Shëndetësor & Rekordet e Vaksinimit*
- *Certifikatat e lindjes për të gjithë motrat dhe vëllezërit që jetojnë në shtëpi ose një kopje e vitit të kaluar të taksave*
- *Kopje e Ceqeve (4 kopje konsektive të ceqeve ose 2 për ata që paguhen çdo 2 javë)*
- *Verifikim i Shkollës (programi dhe fatura)*
- *Informacion i Urdhërit Ndalues (Restraining Order Information) (Nëse është e aplikueshme)*
- *Informacioni i Kujdestarisë (Nëse është e aplikueshme)*
- *Vërtetim i adresës për prindin që mungon (nëse është e aplikueshme)*

Tarifat për vendet e programit me kohë të plotë vendosen nga EEC dhe bazohen në të ardhurat e familjes.

Bashkë-Pagesa e Prindit (co- payments):

7:30 AM - 4:30 PM – janë sa ½ e tarifës ditore për madhësinë e familjes së tyre

Familjet faturohen çdo muaj dhe u kërkohet që të plotësojnë një kontratë përpara se fëmija i tyre të hyjë në program.

Abuzimi i Fëmijës & Politika e Neglizhimit

Ligjet e Përgjithshme të Massachusetts, Kapitulli 119, Seksioni 51, A & B drejtojnë raportimin e abuzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijës dhe urdhëron të gjithë punonjësit profesionalë të shkollës të raportojnë tek Departamenti i Fëmijëve dhe Familjeve (Department of Children and Families) (DCF) rastet e dyshuara të abuzimit të një nxënësi.

Cdo anëtar i stafit të Head Start që ka shkak të arsyeshëm të besojë se abuzimi ose neglizhenca kanë ndodhur duhet të punojë me Mbështetësin e Shërbimeve Familjare të shkollës për të bërë një raport me Departamentin e Fëmijëve dhe Familjeve (DCF). Zakonisht, familjet do të kontaktohen në lidhje me bërjen e raportit, përjashtim bëjnë rastet kur situata është kritike ose e rrezikshme.

Mbështetësi i Shërbimeve Familjare të Head Start do të vazhdojë të punojë dhe ndihmojë familjet pavarësisht veprimit që do të merret nga Agjensia ose Departamenti i Fëmijëve dhe Familjeve (DCF)

Fillimi i Shkollës

Të gjithë fëmijët duhet të jenë në klasë cdo ditë jo më vonë se 9:00am ose 1:00p.m nëse janë të regjistruar në klasat e mbasdites. Sjellja me vonesë e fëmijës në shkollë u shkakton atyre që të humbasin mundësi të rëndësishme edukimi. Vonesat e vazhdueshme do të çojnë në një mbledhje me Mbështetësin e Shërbimeve Familjare. Nëse do të vini me vonesë ju lutem telefononi shkollën sa më shpejt të jetë e mundur për ta informuar.

Pjesëmarrja ka Rëndësi

Pjesëmarrja e mirë (mos bërja e mungesave) bën një diferencë shumë të madhe dhe shkon dorë më dorë me suksesin në shkollë. Ndiemoni fëmijën tuaj që të ketë sukses duke krijuar që në fillim zakonin e mos bërjes së mungesave. Nëse fëmija juaj do të mungojë, ju lutem kontaktoni stafin e zyrës kryesore në qendër për ti informuar ata për arsyen e mungesës. Nëse ne nuk marrim një telefonatë nga ju, ne do t'ju telefonojmë juve. Ne e bashkëpunojmë mbështetjen tuaj në lidhje me këtë çështje.

Lëshimi i Fëmijëve /Rregullat e Marrjes

Anëtarët e stafit të Head Start ***mund ti lëshojnë fëmijët vetëm tek prindërit, kujdestarët, ose tek ata që janë renditur në formën e autorizimit për marrjen e fëmijës.***

Prindërve/kujdestarëve do tu kërkohet ta plotësojnë këtë formë kur fëmija fillon shkollën. Është përgjegjësia e çdo prindi/kujdestari për të njoftuar shkollën për ndonjë ndryshim ose rinovim. Vetëm personat mbi 18 vjeç janë të lejuar që të marrin një fëmijë nga shkolla, me

përrjashtim të rastit kur prindi është minoren. ***Fëmijët do të lëshohen vetëm tek personat e autorizuar mbi 18 vjeç dhe që kanë një dokument identifikimi me fotografi.***

Të gjithë prindërit/kujdestarët ose personat e tjerë të autorizuar duhet të presin tek ndalesa/stacioni i autobusit çdo mëngjes dhe të presin fëmijën e tyre tek ndalesa e autobusit çdo mbasdite. ***Fëmijët do të lëshohen vetëm tek ata individë që janë të autorizuar në listën e marrjes.*** Cdo ditë një prind/kujdestar ose person i autorizuar duhet të kenë ***me vete një dokument identifikimi me fotografi.*** Ky dokument identifikimi do të verifikohet nga monitoruesi i autobusit të Head Start. Nëse ju nuk keni një dokument identifikimi me fotografi ju lutem takohuni me një anëtar të stafit të Head Start për t'ju ndihmuar në sigurimin e një dokumenti të tillë.

Nëse ju nuk jeni tek ndalesa e autobusit kur vjen autobusi fëmija juaj do të kthehet tek ndërtesa e shkollës. Nëse kjo gjë ndodh është përgjegjësia e prindit/kujdestarit ose personit të autorizuar për të marrë masat për marrjen e fëmijës nga shkolla. Incidente të përsëritura të mos-marrjes së fëmijës nga ndalesa e autobusit mund të rezultojnë në përfundimin e shërbimeve të transportit.

Transporti me autobus është i kufizuar dhe jo i garantuar!

Regullat e Identifikimit me Fotografi

Cdo prind/kujdestar ose person i autorizuar i marrjes duhet ti tregojë cdo ditë një dokument identifikimi me fotografi anëtarit të stafit të zyrës. Anëtar i stafit do ti japë personit të autorizuar një kartë që do ta identifikojë atë si personin e duhur për të marrë fëmijën. Kjo kartë do të lihet me ekipin mësimor të klasës. Ky proces do të përsëritet çdo ditë pavarësisht se sa mirë stafi e njeh personin marrës.

Kjo bëhet për arsye sigurie për fëmijën tuaj! Një dokument identifikimi me fotografi kërkohet për marrjen e fëmijës

Nëse ju nuk keni një dokument identifikimi me fotografi stafi i ndërtesës do të bëjë një për ju pa pagesë. Ju lutem pyesni një anëtar të stafit të Head Start për t'ju ndihmuar në këtë proces.

Ndryshime Emergjente në Autorizimin e Personave marrës

Emergjencat mund të ndodhin në çdo kohë. Nëse një prind/kujdestar ose person i autorizuar nuk mund ta marrë dot fëmijën nga shkolla, ose nga ndalesa e autobusit, është përgjegjësia e prindit/kujdestarit ose e personit të autorizuar të kontaktojë shkollën para orës 12:00 në mesditë. Telefonuesi duhet të thotë ***kodin e fëmijës (kjo është diçka që vetëm ju duhet ta dini) kur të telefonojë zyrën qendrore. Mos ja tregoni askujt kodin tuaj.***

Rregullat e Transportit

Programi ofron transport të limituar me autobus. Transporti me autobus rezervohet për familjet që dëshmojnë se kanë nevojë. ***Familjeve nuk u garantohet transporti.***

Prindërit/kujdestarët që shihen rregullisht tek stacioni/ndalesa e autobusit me makinë do të kërkohet që të ofrojnë transportin e tyre nëse ata nuk demostrojnë se kanë nevojë për këtë shërbim.

Ndalesat e autobusit janë planifikuar për të minimizuar kohën që fëmija shpenzon në autobus. Ndalesat e autobusit nuk mund të ndryshojnë me përjashtim të rrethanave speciale.

Cdo autobus Durham është i pajisur me sisteme komunikimi dy rrugësh, pajisje të përshtatëshme sigurie, video kamera, dhe monitorues autobusi. Programeve Head Start u kërkohet me ligj që të pajisin çdo autobus me kufizime individuale për sigurinë e fëmijës. Programi ofron përgatitje për procedurat e evakuimit të autobusit, sigurinë e autobusit dhe këmbësorëve, dhe përdorimin siç duhet të kufizimeve të sigurisë brenda 30 ditëve nga fillimi i shkollës. Njoftimet që informojnë familjet për këto përgatitje u janë dërguar në shtëpi. Të gjitha familjet janë të mirëpritura të marrin pjesë.

Informacioni për sigurinë e autobusit është i disponueshëm për të gjithë prindërit/kujdestarët dhe dërgohet në shtëpi me fëmijët. Gjatë Open House dhe eventeve të tjera familjare informacione shtesë janë të disponueshme. Nëse keni ndonjë pyetje kontaktoni një anëtar të stafit të Head Start.

E Drejta e Hyrjes në Rekordet e Nxënësit

Programi Head Start është përgjegjës për privatësinë dhe sigurinë e të gjitha rekordeve të nxënësit që mbahen në ndërtesat e shkollës. Personeli i mëposhtëm ka të drejtë hyrjeje në rekordet e nxënësit kur performojnë detyrat e tyre zyrtare:

Ky personel përfshin:

Mësues, Koordinatorë të Qendrës, Koordinatorë, Mbështetës/Kolegë të Shërbimeve Familjare, Stafi i Edukimit Spacial, Sekretarët, Infermierët, dhe stafi tjetër shëndetësor siç janë Dietologu ose Higjenisti Dentar, dhe Administratorët që janë punësuar nga Programi Head Start.

Stafi i Edukimit Special të Shkollave Publike të Worcester-it që vlerëson pajtimin e fëmijës me Kapitullin 71B me kërkesat e Ligjeve të Përgjithshme të Massachusetts gjithashtu do të kenë akses të rekordeve të fëmijës

Personeli i departamenteve lokale, shtetërore, dhe federale gjetë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare. Kjo përfshin Departamentin e Fëmijëve dhe Familjeve, çdo Gjykatë, Zyrën e Hetimeve Speciale të Mirëqënies (Welfare) dhe Mashtrimin, Administrimin për Fëmijët dhe Familjet, etj.

Individët që shërbejnë në rolin prindëror duhet të kenë të drejtë për rekordet e nxënësit:

- prindi që ka të drejtën e kujdestarisë (kujdestarinë fizike)
- Kujdestari ligjor
- Personi i autorizuar ligjërisht për të vepruar në emër të nxënësit ose në bashkëpunim me babain, nënën ose kujdestarin e nxënësit

* Prindërit jo-kujdestarë **nuk duhet** të kenë të drejtë për rekordet e nxënësit kur:

- Prindit i është mohuar kujdestaria ligjore bazuar në kërcënim për sigurinë e fëmijës ose prindit që ka të drejtën e kujdestarisë.
- Prindit i është mohuar e drejta e vizitave ose është urdhëruar për vizita të mbikqyrura.
- E drejta e prindit për të takuar fëmijën ose prindin që ka kujdestarinë është kufizuar nga një urdhër mbrojtës i përkohshëm ose i përhershëm, me përjashtim të rasteve kur urdhëri mbrojtës ose çdo modifikim pasues e lejon aksesin në mënyrë specifike.

Ligji i Përgjithshëm i Massachusetts, Kapitulli 71, 34H, kërkon që prindi që nuk ka të drejtën e kujdestarisë të paraqesë një kërkesë me shkrim tek administrata e shkollës për të pasur akses të rekordeve të nxënësit.

Pasi kërkesa me shkrim të jetë shqyrtuar për informacionin e nxënësit, administrata duhet të rishikojë rekordet e nxënësit për çdo dokument që limiton ose kufizon aksesin e prindit. Administrata duhet të njoftojë menjëherë prindin që ka kujdestarinë për marrjen e kërkesës. Njoftimi duhet të bëhet me postë rekomande të garantuar dhe postë e klasit të parë. Ky njoftim duhet që të informojë prindin që ka kujdestarinë se informacioni i kërkuar do të jepet pas 21 ditësh, me përjashtim të rastit kur prindi që ka kujdestarinë i ofron Administratës dokumenta me urdher gjykate e cila ndalon kontaktet me fëmijën ose ndalon dhënien e informacionit për shkak të një urdhëri të përkohshëm ose të përhershëm ose çdo urdhër pasues që modifikon urdhërin mbrojtës dhe që specifikisht nuk lejojnë akses të informacionit të përshkruar në seksionin e mësipërm. Nëse në Administratë paraqitet një urdhër nga një Gjyqtar i Gjykatës së Familjes ose Homologimit (Probate) që ndalon dhënien e informacionit, shkolla duhet të ndërpresë menjëherë dhënien e informacionit dhe të njoftojë prindin që bëri kërkesën se procesi për dhënien e informacionit është pushuar.

Programi Head Start i Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës kërkon kopje të të gjitha gjitha marrëveshjeve të kujdestarisë si dhe programit të vizitave për të gjithë fëmijët e regjistruar. Me ligj, anëtarëve të stafit të Head Start u kërkohet të zbatojnë të gjithë urdhërat ekzistues të gjykatës dhe programin e vizitave të imponuar nga gjykata. Nëse nuk ka program vizitash të imponuar nga gjykata, Programi Head Start rezervon të drejtën që ti kërkojë

prindit/kujdestarit që ka kujdestarinë që të firmosë një dokument me shkrim që përcakton marrëveshjen e tyre rreth vizitave. Pa pëlqim ose aprovim paraprak me shkrim nga prindi/kujdestari që ka të drejtën e kujdestarisë, programi nuk do ta lëshojë një fëmijë tek një prind që nuk ka të drejtën e kujdestarisë jashtë programit të tyre të përcaktuar të vizitave.

Informacioni Shëndetësor

KUR DUHET TE MOS E DERGOJ FEMIJEN NE SHKOLLE POR TA MBAJ NE SHTEPI ?

- Nëse ai/ajo ka temperature **mbi 100 gradë**. Temperatura duhet të jetë normale për 24 orë **pa** ndihmën e Tylenol ose Motrin.
- Nëse ai/ajo diagnostikohet me **faringit** (strep throat). Fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi derisa ai/ajo të ketë marrë antibiotikë për **24 orë** të plota.
- Nëse fëmija juaj **ka vjellë** gjatë natës ose në mëngjes.
- Nëse fëmija juaj **ka diarre** gjatë natës ose në mëngjes.
- Nëse fëmija juaj ka **kollë që prodhon lagështirë** (moist productive cough), **kongjestion në gjoks** (chest congestion) ose **kullim të trashë të hundëve** (thick nasal drainage).
- Nëse fëmija juaj ka **sy të skuqur dhe të ënjtur që kanë të kruajtura si dhe kullim me ngjyrë të verdhë**.
- Nëse fëmija juaj ka **morra të gjalla**.
- **Ju lutem** kontaktoni shkollën ose infermierin e shkollës nëse fëmija juaj ka një sëmundje ngjitëse siç janë **morrat e kokës** (*head lice*), **lia** (*chicken pox*), **fruthi** (*measles*), **dermatocitoza** (*ringworm*), **puçra lëkure** (*impetigo*) ose **zgjebje** (*scabies*).

LISTE KONTRROLI E SIMPTOMAVE TE GRIPIT;

A DUHET TA MBAJ FEMIJEN NE SHTEPI?

- A ka pasur fëmija juaj temperaturë 100.4 gradë ose më të lartë gjatë 24 orëve të kaluara?
- A ka fëmija juaj kollë **OSE** dhimbje fyti?

Nëse i jeni përgjigjur PO të dyja pyetjeve të mësipërme, mbajeni fëmijën tuaj në shtëpi.

Fëmija juaj ka një sëmundje gripale.

A MUND TE KTHEHET FEMIJA IM NE SHKOLLE?

- A ka pasur fëmija juaj temperaturë 100.4 gradë ose më të lartë gjatë 24 orëve të kaluara?
- A ka marrë fëmija juaj acetaminophen (Tylenol) ose ibuprofen (Motrin ose Advil) gjatë 24 orëve të kaluara?

Nëse i jeni përgjigjur JO të dyja pyetjeve të mësipërme, fëmija juaj mund të kthehet në shkollë.

Nëse i jeni përgjigjur PO njërës prej pyetjeve të mësipërme, fëmija juaj NUK MUND të kthehet në shkollë. *Mbajeni fëmijën tuaj në shtëpi edhe një ditë tjetër për të parë për simptomat të tjera. Pastaj përdor prapë pyetjet e listës së kontrollit për të vendosur nëse fëmija juaj duhet të vazhdojë të qëndrojë në shtëpi ose jo.*

Infermieret e Head Start do të jenë përgjegjës për të administruar mjekimin tek fëmijët vetëm me një urdhër të shkruar nga doktori ose klinika e fëmijë. Ilaçi duhet të jetë në kutinë origjinale dhe të jetë i etiketuar me emrin dhe mbiemrin e fëmijës, datën që ilaçi është mbushur, datën e skadencës, dhe udhëzime se si të administrohet dhe ruhet ilaçi.

Përrjashtim bën vetëm epi-pen ose ilaçe të tjera si Benadryl që jepen nga një mjek si linja e parë e mbrojtjes për të parandaluar shokun anafilaktik. Aparatet thithëse të ilaçit do të administrohen në rastin e një vështirësie në frymëmarrje nëse është përshkruar nga mjeku i fëmijës.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem takoni infermierin e ndërtesës ose Koordinatorin e Qendrës

Këshilla dhe Kujtesa për Familjet

- Ju lutem mos dërgoni lodra ose ushqime me fëmijën tuaj
- Ushqimet dhe lodrat nuk lejohen në autobus
- Fëmijët duhet të veshin rroba dhe këpucë të rehatshme.
- Për arsye sigurie fëmijët nuk duhet të veshin shapka ose këpucë me gishta të hapur.

- Visheni fëmijën çdo ditë në mënyrë të përshtatëshme me kohën sepse ata do të luajn rregullisht jashtë. (nëse e lejon koha) .
- Dërgoni një palë rroba të tjera që të lihen në shkollë me fëmijën tuaj në rast të ndonjë urgjence.
- Përshtatuni me kohën e sjelljes për në shkollë dhe të marrjes nga shkolla, dhe ndiq të gjitha procedurat e sjelljes dhe marrjes së fëmijës tuaj .
- Përfitoni nga programet për të shtuar njohuritë tuaja rreth zhvillimit të fëmijës.
- Shko vullnetar në program dhe përfito nga mundësitë e udhëheqjes së prindit.
- Merrni pjesë në mbledhjet me prindërit, grupet e punës, grupet këshilluese, dhe në mundësitë e tjera për tu bërë një pjesëmarrës aktiv në edukimin e fëmijës tuaj.
- Kur e sillni ose e merrni fëmijën tuaj në shkollë ose në ndalesën e autobuzit, ne ju kërkohet që ti shmangeni përdorimit të telefonit celular.
- Bashkëpunoni me mësuesit dhe anëtarët e tjerë të stafit të Head Start.

Programi Mësimor në Klasë

Programi përdor program mësimor të bazuar në kërkime dhe që mbështet një edukim të hershëm të cilësisë së lartë. Aktivitete janë të përshtatëshme me zhvillimin dhe plotëson nevojat individuale të çdo fëmije. Programi mësimor përpudhet me udhëzimet e shtetit për Udhëzimet për Eksperiencën e Mësimin Parashkollor (Guidelines for Preschool Learning Experiences), Kornizat e Programit Mësimor të MA (MA Curriculum Frameworks), dhe me Head Start Early Learning Outcomes Framework. Mësimi është i qëllimshëm dhe i lejon çdo fëmije që të eksplorojë, marrë pjesë në lojë, dhe të ketë mundësi që të ndërtojë aftësitë themelore që janë të rëndësishme si për gadishmërinë në shkollë ashtu dhe për një sukses afatgjatë. Mësuesit përdorin vëzhgimet dhe shembuj nga puna e fëmijës për të vlerësuar progresin e fëmijës tre herë në vit. Ky informacion ndahet me prindërit/kujdestarët gjatë konferencave/mbledhjeve prind/mësues dhe përdoret si bazë për praktikën mësimdhënëse në klasë dhe për të krijuar mundësi për një zhvillim profesional të cilësisë së lartë për stafin

Konferencat/Mbledhjet Prind-Mësues

Konferencat formale Prind/Mësues mbahen dy herë në vit. Këto konferenca njohin prindin me programin mësimor dhe ofrojnë mundësi për mësuesit dhe prindërit/kujdestarët për të punuar së bashku si një skuadër, për të mbështetur fëmijën që të ketë sukses në shkollë.

Vizitat në Shtëpi

Ekipe mësimdhënësish, Infermierë, Mbështetës të Shërbimeve Familjare dhe staf tjetër i Head Start do të zhvillojnë vizita në shtëpi gjatë gjithë vitit shkollor. Qëllimi i vizitave në

shtëpi është që të mësohet më shumë rreth çdo fëmije dhe për të ndihmuar në ofrimin e burimeve dhe mbështetjes për të gjithë familjen.

Rregullat për Festimin e Festave

Për të respektuar diversitetin kulturor të familjeve dhe stafit tonë, programi nuk feston festat në shkollat tona. Nëse keni ndonjë pyetje ju lutem flisni me një anëtar të stafit të Head Start.

Rregullat e të Luajturit Jashtë/Në Natyrë

E luajtura jashtë është shumë e rëndësishme për fëmijët e vegjël dhe është pjesë e rregullt e programit mësimor. Ju mund të nxisni kënaqësinë e të gjitha aktiviteteve në natyrë duke e veshur fëmijën tuaj në përputhje me kohën. Fëmijët do të marrin pjesë në aktivitete në natyrë, nëse e lejon moti

Rregullat e Udhëtimit në Terren (Field Trip Policy)

Udhëtimet në terren pasurojnë aktivitetin mësimor në klasë dhe ofrojnë mundësi për prindërit/kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të familjes që të shpenzojnë kohën me fëmijët e tyre. Prindërit/kujdestarët janë të mirëpritur që vijnë me fëmijët e tyre në udhëtimet në terren. Prindërit/Kujdestarët duhet që të firmosin një formë lejimi për udhëtimin në terren përpara se të marrin pjesë në ndonjë udhëtim në terren. Udhëtimet në terren mund të përfshijnë, Ecotarium, Stacioni i Zjarrfikëses, Supermarket, ose vende të tjera.

Ju do të njoftoheni para çdo udhëtimi në terren.

Paaftësitë/Shëndeti Mendor/Shërbimet e Edukimit Special

Të paktën 10 përqind e të regjistruarve në Head Start përbëhet nga fëmijë me nevojë speciale specifike ose paaftësi. Të gjithë fëmijët kontrollohen brenda 45 ditësh nga regjistrimi. Rezultatet e kontrollit ndahen me çdo familje. Bëhet çdo përpjekje për të plotësuar nevojat e çdo fëmije. Në disa raste mund të rekomandohet një referencë. Prindërit, mësuesit, dhe stafi tjetër i Head Start punojnë bashkë për të përcaktuar nëse duhet një referim ose vlerësim. Programi punon me WPS dhe agjensi të tjera për të siguruar se plotësohen nevojat e të gjithë fëmijëve

Të gjithë prindërit/kujdestarët janë të ftuar të ndjekin një trajnim të Special Education Advocacy që ofrohet çdo vjeshtë.

Disiplina dhe Rregullat e Drejtimit

Disiplina dhe drejtimi janë konstante dhe të bazuara në mirëkuptimin e nevojave dhe zhvillimit individual të çdo fëmije. Ndiqen parimet e mëposhteme:

1. Ndërshkimi trupor përfshirë shuplakat nuk përdoret
2. Asnjë fëmijë nuk i nënshtrohet një ndërshkimi të rëndë ose mizor, poshtërimit ose abuzimit verbal.
3. Asnjë fëmijë nuk i mohohet ushqimi si formë ndërshkimi.
4. Asnjë fëmijë nuk ndërshkohet, poshtërohet, ose dërgohet në shtëpi për ndotje, lagie ose mos përdorim të tualetit. Cdo fëmijë i pamësuar me tualetin ose që ka një zhvillim specifik ose gjendje mjekësore ka një procedurë specifike për tualetin. Kjo procedurë reflekton një marrëveshje ndërmjet prindit/kujdestarit dhe ekipit të Head Start dhe është e përfshirë në planin individual të fëmijës.
5. Sjellja e duhur është e qartë dhe e specifikuar thjeshtë. Programi njeh që fëmijët janë në procesin e të mësuarit se si të funksionojmë si pjesë e një grupi dhe çdo fëmijë inkurajohet sipas nevojave të tij/saj. Bindja vlerësohet. Sjelljet e papërshtatëshme do të injorohen nëse është e mundur.

Procesi i Apelimit për Prindërit/Kujdestarët në Lidhje me Shërbimet e Edukimit Special.

Programi përpiket që të edukojë familjet për rëndësinë e identifikimit të hershëm dhe shërbimet për fëmijët me paaftësi. Pjesëmarrje e prindërve/kujdestarëve në procesin e Edukimit Special është esenciale dhe e dobishme. Prindërit/Kujdestarët do të kuptojnë më mirë shërbimet dhe do të sigurohen që fëmija i tyre do të zhvillojë potencialin e tij/saj plotë në një mjedis sa më pak kufizues.

Nëse prindi/kujdestari nuk e pranon autoritetin e programit për të vazhduar me identifikimin e hershëm ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Një mbledhje planifikohet me Koordinatorin e Paaftësisë/Shëndetit Mendor dhe me prindin/kujdestarin në mundësinë e tyre më të parë.
- Koordinatorin e Paaftësisë/Shëndetit Mendor shqyrton rezultatet e kontroleve me familjen dhe ofron shpjegime shtesë.
- Nëse vështirësia e pranimit të rezultateve vazhdon, prindit/kujdestarit i ofrohet mundësia për të marrë pjesë në procesin e kontrollit, i cili planifikohet në një kohë të përshtatëshme për familjen. Nëse prindi/kujdestari nuk ndihen të qetë me këtë alternativë një mbledhje pasuese do të planifikohet gjatë 2 muajve të ardhshëm.
- Nëse prindi/kujdestari vazhdojnë të mos ndjehen të qetë me shërbimin edhe pas mbledhjes së dytë, refuzimi i tyre dokumentohet dhe pranohet.

Shërbimet e Shëndetit Mendor

Programi jonë i hap rrugën fëmijës tuaj për të qënë i shëndetshëm dhe për të pasur vetëbesim. Head Start ofron shërbime të shëndetit mendor për të ndihmuar çdo fëmijë që të arrijë sukses

në shtëpi, shkollë dhe në të ardhmen. Shërbimet e Shëndetit Mendor mbikqyren nga Koordinator i Paaftësisë/Shëndetit Mendor që është i çertifikuar si psikolog i shkollës. Një qasje e integruar që forcon shëndetin social, të sjelljes dhe atë emocional të fëmijëve dhe familjeve përfshin:

- Kontrolle formale dy herë në vit për fëmijët që adresojnë zhvillim social/emocional. Rezultatet e kontrolleve ndahen me familjet.
- Kontaktonet e vazhdueshme me prindërit ofrojnë mundësi për të kërkuar informacion rreth vëzhgimeve ose shqetësimeve që prindërit kanë për mirëqënien mendore të fëmijëve të tyre.
- Një plan sjelljeve zbatohet kur identifikohet një shqetësim i ri ose i përsëritur për zhvillimin. Mësuesve u ofrohet mbështetje në lidhje me sjelljen dhe zhvillimin e fëmijës.
- Ndhimë shtesë ofrohet nëpërmjet kontakteve me partnerë e komunitetit. Konsulentët për Shëndetin Mendor ofrojnë drejtim nëpërmjet vëzhgimeve në klasë, trajnimit, kontakteve prind/kujdestar, manaxhimit të rasteve, referencave, dhe rekomandimeve për trajtim nëse është e nevojshme.
- Familjet marrin edukim dhe mbështetje në lidhje me identifikimin e hershëm, parandalimin dhe trajtimin e shëndetit mendor. Temat përfshijnë mënyra për të forcuar mjedisin e tyre, marrëdhëniet, sjellje sociale e përshtatëshme për moshën, pritshmëri realiste, dhe vendosjen e afateve.

Shërbimet e Ushqimit

Të gjithë fëmijëve u shërbehet çdo ditë mëngjes dhe drekë. Fëmijëve që janë me ditë/kohë të plotë u shërbehet edhe një ushqim i shpejtë (snack). Programi ofron 1/3 deri në 1/2 e nevojave ushqimore ditore të fëmijës. Të gjitha ushqimet plotësojnë rregullat dhe modelimin e Programit të USDA të Kujdesit të Ushqimit për Fëmijët dhe të Rriturit (USDA Child and Adult Care Food Program based in Dietary Guidelines for Americans) që bazohet në Rregullat e Dietave të Amerikanëve. Ushqimet e përdorura janë me pak sheqerna, yndyrna, dhe kripëra dhe përfshijnë një varietet frutash, perimesh, drithërash, proteinash dhe qumështi. Shërbehen në stil familjar me fëmijët dhe mësuesit që ulen bashkë në të njëjtë tavolinë. Fëmijëve u mësohet larja e duhur e duarve, pjesëmarrja në uljen në tavolinë, dhe ndihmesa në vetëpastrim. Nëse fëmija juaj ka shqetësime specifike për dietën, përfshirë alergji nga ushqimi ose intolerancë për ndonjë ushqim, do ju ofrohet një formë që duhet që të plotësohet dhe të firmoset nga doktori i fëmijës.

Shëndeti Oral/Larja e Dhëmbëve

Fëmijët lajnë dhëmbët çdo ditë. Cdo fëmijë ka furçën e tij/saj të dhëmbëve të etiketuar, e cila jepet nga programi. Furçat ruhen në një mbajtëse, dhe mbahen larg fëmijëve kur nuk janë në përdorim. Larja e dhëmbëve mbikqyret nga stafi që është trajnuar në monitorimin e aktiviteteve. Higjenistët Dentarë ofrojnë mbështetje në klasë si dhe edukim dentar për të gjithë fëmijët. Higjenisti dentar gjithashtu takohet dhe me prindërit/kujdestarët rreth problemeve të shëndetit oral dhe punon me çdo familje për të ngritur një shtëpi dentare. Rekomandohet që fëmijët të kenë takim me dentistin çdo gjashtë muaj. Higjenistra Dentare e Head Start do të dërgojë në shtëpi kujtesa për familjet.

Shëndeti dhe Siguria/Parandalimi i Dëmtimeve

Anëtarëve të stafit të Head Start u kërkohet të kenë një certifikimin aktual për Ndhmën e Shpejtë dhe CPR për të qënë familjar me procedurat e duhura të emergjencësh shëndetësore dhe dentare. Udhëzimet e Ndhmës së Shpejtë dhe CPR janë të vendosura në çdo klasë. Politikat dhe procedurat e emergjencës së programit, rrugët e evakuimit, si dhe numrat lokalë të emergjencës janë të vendosura në çdo hyrje. Programi përpiket të ofrojë një mjedis të sigurtë duke kryer audite të rregullta të sigurisë si dhe përgatitje të emergjencave. Ofrohen udhëzime të vazhdueshme për fëmijët rreth rregullave të sigurisë. Cdo fëmijë i dëmtuar do të marrë trajtim të menjëhershëm. Prindërit/Kujdestarët njoftohen për të gjitha dëmtimet. Dëmtimet që kërkojnë kujdesin e personelit mjekësor jo të ndërtesës, do të njoftohen menjëherë prindit/kujdestarit. Për këtë arsye Head Start u kërkon familjeve që të plotësojnë një formë për lejimin e trajtimit mjekësor dhe dentar emergjent.

Celësi i parandalimit të dëmtimeve është një trajnimi i vazhdueshëm për fëmijët, familjet dhe stafin. Fëmijët marrin trajnim të rregullt për përdorimin e kufizuesve të sigurisë së fëmijës, sigurinë e këmbësorëve, evakuimin nga autobusi, procedurat e evakuimit të ndërtesës si dhe prova evakuimi në rast zjarri. Informacin rreth sigurisë u ofrohet familjeve rregullisht. Kutitë me sendet e ndihmës së shpejtë mbahen në çdo klasë, zyra, si dhe vende të rëndësishme në të gjithë ndërtesën. Kutitë e klasave janë të lëvizshme dhe shoqërojnë klasat gjatë lojërave, në vendet jashtë, si dhe në udhëtimet në terren.

Cdo vend/ ndërtesë e Head Start është e pajisur me Automatic External Defibrillator (AED) dhe po ashtu ka staf të caktuar në çdo qëndër të cilët janë trajnuar për përdorimin e kësaj pajisjeje.

Shërbimet Familjare/Angazhimi Familjar

Mbështetësit e Shërbimeve Familjare (FSA) të Head Start (Head Start Family Service Advocates) punojnë për të krijuar marrëdhënie me çdo familje nëpërmjet proceseve të vizitave në shtëpi, kontakteve një me një, telefonatave, shënimeve, dhe aktiviteteve të tjera.

Stafi punon në partneritet me familjet për të ndërtuar mbi anët e tyre të forta dhe për të ndihmuar ato në vënien e qëllimeve realiste dhe arritjen e angazhimeve. Mbështetësit e Shërbimeve Familjare janë të disponueshëm për të asistuar familjet në identifikimin e shërbimeve, mbështetjeve, dhe burimeve, dhe për ti ndihmuar ato në arritjen e potencialit të tyre të plotë; duke rezultuar në fëmijë që janë të shëndetshëm dhe gati për në shkollë. FSA punon me agjensitë e komunitetit dhe me organizata të tjera për të ofruar ndihmë të koordinuar për familjet. FSA e Head Start ofron konsultime afatshkurtër, ndërhyrje në kriza, mbështetje dhe referenca.

***Familjet inkurajohen për të qënë vullnetarë në Program.
Disa mundësi për të qënë aktivisht të angazhuar përfshijnë:***

- Leximi i një libri fëmijës tuaj ose një grupi të vogël në klasë
- Pjesëmarrja në mbledhje me prindërit
- Ofrimi i ndihmës për infermieren ose sekretaren
- Ndjekja e eventeve familjare
- Ndihmë për fëmijët që të mbjellin lule në kopështet e tyre të ngritura
- Pjesëmarrja në udhëtimet në terren
- Ndjekja e mbledhjeve konsultuese
- Pjesëmarrje në mundësitë e drejtimit
- Ndarja e kulturës së familjes tuaj me klasën e fëmijës tuaj

Mbledhjet me Prindërit

Si prindi i një fëmije në programin Head Start ju jeni tashmë anëtar i grupit të prindëve të shkollës tuaj. Mbledhja e parë bëhet në vjeshtë dhe mbledhjet mbahen gjatë gjithë vitit shkollor. Prindërit luajnë një rol të rëndësishëm në planifikimin e aktiviteteve të vitit. Këto takime programohen në orare të ndryshme, në mënyrë që të përmbushen nevojat e sa më shumë familjeve që të jetë e mundur. Prindërit/kujdestarët do të kenë mundësi që të marrin pjesë në një aktivitet ma fëmijën e tyre, dhe pastaj të marrin pjesë në mbledhjen me prindërit gjatë kohës që fëmijët janë në kujdesin e stafit të Head Start. Si përfaqësues i komitetit të qëndrës tuaj, ju zgjidhni përfaqësuesit që shërbejnë në Bordin Drejtues të Programit. Bordi Drejtues punon nga afër me Administratën e Head Start dhe me anëtarët e Bordit të Shkollës për të marrë vendime të rëndësishme që ndikojnë në funksionimin e programit.

Bordi Drejtues/Këshilli i Politikave

Bordi Drejtues/Këshilli i Politikave përbëhet nga disa palë të interesuara. Grupi më i madh janë prindërit e fëmijëve që janë të regjistruar aktualisht në shkollë. 51% e anëtarëve duhet të jenë prindër ose kujdestarë të fëmijëve të regjistruar në program. Pjesa tjetër a anëtarëve përbëhet nga anëtarë të Bordit të Shkollës dhe Përfaqësues të Komunitetit. Grupi merr vendime të rëndësishme rreth veprimeve programore dhe fiskale në bashkëpunim me stafin Administrativ të Head Start dhe dhuruesin.

Anëtarët duhet të kufizojnë numrin e afateve një-vjeçare në një total të kombinuar prej tre vjetësh. Mbledhjet mbahen në të mërkurën e katërt të çdo muaji. Të disponueshëm janë kujdesi për fëmijët si dhe transport i kufizuar. Për më shumë informacion takoni Specialistin e Angazhimit Familjar ose një anëtar të stafit të Head Start.

Mbledhjet/Takimet Konsultative

Disa grupe Konsultimi takohen me manaxherë kryesorë për të diskutuar çështje aktuale që ndikojnë tek fëmijët dhe familjet. Prindërit/Kujdestarët punojnë me stafin, përfaqësuesit e komunitetit ose agjensitë gjatë vitit shkollor. Informacione shtesë rreth këtyre mundësive janë të disponueshme nëse flisni me një anëtar të stafit të Head Start. Bordet e Konsultimit (Advisory Boards) janë: Education, Health Services dhe Male Advisory Board.

Ankimet/Procesi i Ankesave për Familjet dhe Agjensitë e Komunitetit

Programi Head Start i Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës ka krijuar procedurën e mëposhtme për familjet dhe agjensitë e komunitetit për të zgjidhur ankesat ose shqetësimet. Ky proces kërkohet nga Standartet e Performancës së Head Start, 1304.50(d)(2)(v).

- Prindërit/Kujdestarët si dhe përfaqësuesit e komunitetit do të deklarojnë verbalisht ankesën manaxherit të disiplinës brenda 5 ditësh nga dyshimi i ankesës, pakënaqësisë ose shqetësimit.
- Nëse ankesa, pakënaqësia ose shqetësimi nuk zgjidhet brenda 5 ditësh prindi/kujdestari ose përfaqësuesi i komunitetit duhet ta prezantojnë ankesën me shkrim tek Drejtori i Head Start.
- Drejtori i HS do të rishikojë dhe do të marrë masat e duhura për të adresuar ankesën, pakënaqësinë ose shqetësimin brenda 5 ditësh.
- Nëse prindi/kujdestari ose përfaqësuesi i komunitetit mendon se masa nuk ka qënë e drejtë ata mund të paraqesin një apelim me shkrim tek Këshilli i Politikave/Bordi Drejtues i Head Start. Apeli do të rishikohet brenda 5 ditësh dhe do të merren masa.
- Nëse prindi/kujdestari ose përfaqësuesi i komunitetit mendon se masat e marra nga Këshilli i Politikave/Bordi Drejtues nuk është i drejtë ata duhet të paraqesin një apel me shkrim tek Program's Grantee, Shkollat Publike të Worcester-it (WPS). Përfaqësuesi i (WPS) do të përgjigjet me shkrim pakënaqësisë, ankimit ose shqetësimit brenda 5 ditësh dhe vendimi do të jetë përfundimtar.

Verifikimi i Rekordeve Penale/Vullnetarët

Të gjithë anëtarët e stafit janë subjekt i një Verifikimi të Rekordeve Penale ose CORI siç përcaktohet në Udhëzimet e Programit, ACF-PI-HS-08-02 datuar, 14 Prill, 2008 dhe marrjen e shenjave të gishtave (National Background Check). Ky proces hyri në fuqi në Prill 2014.

Vullnetarët e Head Start, prindërit, përfaqësuesit e komunitetit dhe studentët që janë vullnetarë ose praktikantë janë subjekt i një verifikimi të rekordeve Penale (Criminal Records/National Background Checks) përpara se të punojnë ose të jenë vullnetarë në program.

Sipas M.G.L. c.71 & 38 R Shkollat Publike të Worcester-it duhet të kërkojnë një CORI si për punonjësit aktualë ashtu edhe për ata që do të punësohen në të ardhmen si dhe vullnetarët e çdo programi me WPS. WPS mund të kërkojnë një CORI she SORI për çdo nënkontraktues ose punëtor që mund të ketë kontakt direkt dhe/ose të pambikqyrur me fëmijët gjatë kohës që punojnë ose ofrojnë shërbime në ambientet e shkollës.

Një CORI duhet të plotësohet dhe rishikohet përpara se çdo punonjës ose vullnetar i Head Start fillon shërbimin në program dhe do të përsëritet çdo 3 vjet. Proçrsi i marrjes së shenjave të gishtave është kërkesë e vetëm një herë. WPS do të refuzojnë që të punësojnë ose të vazhdojnë të punësojnë ose të pranojnë ose të vazhdojnë të pranojnë shërbimet vullnetare të çdo individi që kontrolli i CORI, në gjykimin e Kontrollorit (Superintendent) ose të emëruarit të tij/saj, tregon një shkelje penale, e cila e skualifikon individin nga pasja e kontaktit direkt ose kontaktit të pa mbikqyrur me fëmijët. Dokumentacioni i CORI do të mbahet në zyrën administrative të HS.

Evakuimi i Ndërtesës/Plani i Përgjigjes ndaj Krizave

Ju do të njoftoheni nëse ka një situatë emergjence që urdhëron evakuimin e ndërtesës së shkollës. Nëse një prind ose/kujdestar nuk mund të kontaktohet, atëherë do të kontaktohet një person i autorizuar në listën e marrjes. Cdo shkollë ka një plan evakuimi, i cili rishikohet çdo vit. Ky informacion është i vendosur në ndërtesat e shkollës dhe ndahet me ju gjatë orientimit, mbledhjeve me prindin, si dhe me buletine dhe njoftime.

Nëse urdhërohet një evakuim fëmija juaj do të shpihet në një vend të paracaktuar nga stafi i Head Start. Asnjë fëmijë nuk do të lëshohet tek prindi/kujdestari derisa ai/ajo të kenë arritur në vendin e paracaktuar të evakuimit. Të gjithë prindërve/kujdestarëve ose personave të autorizuar për marrjen do ju kërkohet të paraqesin një dokument identifikimi me fotografi për të marrë fëmijën. Këta individë duhet të jenë në listën aktuale për marrjen nga shkolla.

Regullat për Lëshimin e Hershëm/Vonesat e Shkollës & Jo Shkollës

Shkollat Publike të Worcester-it do të ushtrojnë një nga opsionet e mëposhtëme kur kushtet atmosferike ose elementë të tjerë diktojnë ndryshim. Këto rregulla do të aplikohen në të gjitha ndërtesat e Head Start.

Anullimi i Shkollave Publike të Worcester-it

Nëse WPS anullojnë shkollën për ditën të gjitha shkollat e Head Start do të mbyllen.

Vonesa në Hapjen e Shkollës

Nëse WPS vonojnë hapjen e shkollës me 1 ose 2 orë, vetëm fëmijët që marrin pjesë në programin me kohë të plotë ose në pjesën e mbasdites të ditës së shkollës, do të vijnë në shkollë sipas vonesës. Të gjitha ndërtesat e Head Start do të hapen me 1 ose 2 orë vonesë në varësi të vonesës. ***Fëmijët që marrin pjesë në programin me gjysëm dite nuk do të kenë shkollë në Ditët me Vonesa!***

Lëshimi i Hershëm

Nëse WPS lejojnë lirim të hershëm nga shkolla do të vepohet si në vijim:

- Klasat me gjysëm dite do të lëshohen në 11:30 A.M.
- Autobusat do të largohen nga çdo ndërtesë shkolle më 11:30 A.M
- Klasat me kohë të plotë-të gjitha familjet do të kontaktohen dhe inkurajohen që të marrin më herët fëmijët e tyre

Njoftimet për ditët pa shkollë ose me vonesë do të bëhen në stacionet e mëposhtëme të radiove the televizioneve

WTAG, 580, AM, WORC, 1310, AM

WBZ, 1030, AM WXLO, 104.5 FM

WSRS, 96.1, FM WCUW, 93.1 FM****

WHDH, Channel 7, WCVB, Channel 5, & WBZ, Channel 4

Informacioni gjithashtu do të postohet edhe në adresën e Internetit të WPS

<http://www.worcesterschools.org>

*** Ky është një transmetim në Spanjsht ndërmjet orës 5:00 A.M dhe 6:00 A.M.

Kontakte të Rëndësishme

Shkolla: _____

Telefoni: _____

Mësuesit: _____

Infermjerja: _____

Ju lutem vini re: Programi kërkon që ju të shmangni përdorimin e telefonave celularë kur sillni ose merrni fëmijën tuaj. Kjo gjë është për sigurinë e fëmijës tuaj!

Zyra e WIC

*A e urreni që prisni për takimin tuaj?
A doni që ta bëni jetën tuaj më të lehtë?*

Programi Head Start i Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës është me fat që ka një zyrë të WIC që ndodhet në programin tonë. Zyra ndodhet në *ndërtesën e Shkollës Mill Swan, që ndodhet në 337 Mill Street*, dhe është e hapur çdo të Martë nga 8:30 A.M -4:00 P.M. Familjet nga të gjitha vendndodhjet e Head Start janë të mirëpritura të lënë takim.

Për më shumë informacion ose për të lënë takim ju lutem telefononi në **(508) 755-4750**

Broshura Familjare

Unë kam marrë një kopje të Broshurës të Familjare të Programi Head Start të Worcester-it për Zhvillimin e Fëmijës dhe i kuptoj përgjegjësitë e mija për t'ju përmbajtur rregullave dhe procedurave të programit.

Unë gjithashtu e kuptoj që shërbimet e përkthimit janë të disponueshme për mua në rast se ato më nevojiten

Firma e Prindit/Kujdestarit

Emri i Fëmijës dhe Numri i Klasës

Numri i Dhomës

Data

